14/01/2021

Në Ditën e Shën Vasilit romët bullgarë festojnë Vitin e Ri



Më 14 janar bashkësia e romëve në Bullgari kremton festën e saj më të madhe – Ditën e Shën Vasilit, ose Bango Vasil – Vasili i Çalë. Festa është e njohur si “Viti i Ri i Romëve” dhe kremtohet nga të gjithë romët – pavarësisht nga feja e tyre.

Në krahinat e ndryshme të Bullgarisë më 14 janar festa shënohet nëpërmjet ritualit “Survakane” /një xhiro rituale nëpër shtëpitë nga një grup fëmijësh ose burrash të pamartuar – beqarë, të cilët trokasin me një shkop të zbukuruar apostafat për rastin, të quajtur “survaçka”, anëtarët e familjes, kafshët, ndërtesat dhe thonë urime nga më të mirat për shëndet, lumturi dhe begati/, ose nëpërmjet mishërimit të kreut të familjes në Bango Vasil, i cili hedh në shtëpi grurë dhe oriz.

E gjithë kjo bëhet me një solemnitet të madh, sepse besohet se sjell pjellori, bagëti, fat të mirë dhe lumturi.

Për shkak të masave anti-epidemike autoritetet rekomandojnë që rituali “survakane” të mbahet vetëm në mjedisin familjar.

— bnr.bg